

FAKULTETI I SHKENCAVE TE NATYRËS DHE SHKENCAVE HUMANE NË
BASHKËPUNIM ME INSTITUTIN E STUDIMEVE NDËRKOMBËTARE ZHVILLLOI
LEKSIONE TË HAPURA MBI “*MODELI SOCIAL EUROPIAN*”

Në datën 12 Prill 2017, në kuadër të Javës së Evropës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Humane në bashkëpunim me Institutin e Studimeve Ndërkombëtare në Tiranë, kanë organizuar “ Ditën e Akademisë Evropiane”. Në këtë veprimtari, ishin të pranishëm studiues, pedagogë e studentë të këtij fakulteti si edhe zv/drejtori i AiiS Jorgji Qirjako. Përgjatë katër ditëve u mbajtën pesë leksione të hapura.

1. “SHQIPTARËT DHE MODELI SOCIAL EVROPIAN” (Mangesitë, pengesat, sfidat, vizionet), nga studiuesi, publicisti dhe shkrimtari Piro Misha.
2. “MODELI SOCIAL EVROPIAN DHE INTEGRIMI EVROPIAN” nga pedagogia e Universitetit “ Fan S. Noli” të Korçës, Doktorante Maria Dojçe.
3. “DEMOKRACIA E BRENDSHME E PARTIVE” nga pedagogu i Universitetit “Aleksandër Moisiu” të Durrësit, Rigels Xhemollari.
4. “REFLEKTIME FILOZOFIKE MBI MODELIN SOCIAL EUROPIAN”, nga pedagogu i Fakultetit të Shkencave Sociale, Tiranë, Prof. Dr. Gjergj Sinani.
5. “DREJT NJË RIPËRCAKTIMI TË KONTRATËS SOCIALE”, nga zv.drejtori i AiiS Alba Çela.





